



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI

Nr. 550 Prot.

Tiranë, më 06.04.2018

VENDIM
Nr. 19 datë 06.04.2018

MBI

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE ME KOHË TË PLOTË,
NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR
PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020**

Në zbatim të neneve 23,38,74,76 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-te e Republikës së Shqipërisë", në Rregulloren e UST-së neni 14 pika aa; si dhe në bazuar në shkresën nr. 2641 prot, dt. 08.03.2018 "Për kriteret e pranimit në programet e studimit të IAL për vitin akademik 2019-2020", në Vendimin nr. 50, dt. 26.03.2018 të Rektoratit të UST, Senati me Vendim Qarkullues

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve me kohë të plotë në programet e studimit të ciklit të parë për vitin akademik 2019-2020, pranë FSHL dhe FVFR.

A. FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

Programi i studimit Bachelor në "Shkencat e Lëvizjes"

- Do të pranohen në programin e studimit të Ciklit të I-rë Bachelor në "Shkencat e Lëvizjes" të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave në fuqi.

- Kandidatët i nënshtrohen konkurimit të Testimit Praktik konform testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen web të UST.
- Kandidatët që konkurojnë në këtë program studimi, duhet të plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore miratuar nga UST dhe e shpallur në faqen eeb të saj.
- Kandidatët vlerësohen me pikë të grumbulluara bazuar në rezultatet e konkursit në testimin praktik të UST-së dhe notës mesatare të shkollës së mesme. Sipas Vendimit Nr.7 datë 18.01.2016 të Senatit Akademik të UST, raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe notës mesatares të kandidatit do të jetë në kufijtë 60% me 40%.
- Klasifikimi i kandidatëve bëhet bazuar në sasinë e pikëve totale te grumbulluara, të vendosur në rendin zbritës. Fitojnë kandidatët me numrin më të madh të pikëve të grumbulluara.

B. FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

Programi i studimit Bachelor në “Fushat e Veprimitarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit”

- Kanë të drejtë të pranohen në programin e studimit të Ciklit të I-rë Bachelor në “Fushat e Veprimitarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave në fuqi.
- Kandidatët i nënshtrohen konkurimit të Testimit Praktik konform testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen eeb të UST.
- Kandidatët që konkurojnë në këtë program studimi, duhet të plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore miratuar nga UST dhe e shpallur në faqen web të saj.
- Kandidatët vlerësohen me pikë të grumbulluara bazuar në Rezultatet e konkursit në testimin praktik të UST-së dhe notës mesatare të shkollës së mesme. Sipas Vendimit Nr.7 datë 18.01.2016 të Senatit Akademik të UST, raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe notës mesatares të kandidatit do të jetë në kufijtë 60% me 40%.

- Klasifikimi i kandidatëve bëhet bazuar në sasinë e pikëve totale të grumbulluara, të vendosur në rendin zbritës. Fitojnë kandidatët me numrin më të madh të pikëve të grumbulluara.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT



Prof.Dr. Agron Cuka

